



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Datë 09.09.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË PIKËN NR. 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 66 DATË 25.06.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës”

Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 89/2022, datë 22.12.2022 “Për policinë bashkiake”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.194 datë 22.12.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e bashkisë Durrës”, shkresës nr.10322 prot., datë 01.09.2025 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, shkresës nr.10322/1 prot., datë 02.09.2025 nga Drejtoria Ligjore.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë të konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e një shtese në pikën nr. 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66 datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e bashkisë Durrës”, duke shtuar pas nënpikës 7, nënpikën 8 me emërtimin:

8. Sheshi “26 Nentori 1912”, pranë Stacionit të Trenit, Durrës

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

-

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO. Është në vazhdimësi të një vendimi të konsultuar më parë e të miratuar më parë dhe është harruar të futet në vendim.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mbledhë më datë 09.09.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 8 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

*Kryesuesi e komisionit hap mbledhjen me autarit e rrethit
I pyeti autarit e komisionit nëse, kane pyetje
apo sugjerime ku lidhej me kete pikë.
Autarit nuk kishte pyetje apo sugjerime.*

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

1	Kryetar	Marsida Feshti	
2	Zv/Kryetar	Sami Osmani	
3	Sekretar	Joniada Musaraj	
4	Anëtar	Dorian Isaj	
5	Anëtar	Elisabeta Mataj	
6	Anëtar	Flutura Kasa	
7	Anëtar	Edlira Shemsi	
8	Anëtar	Kontjana Kuçi	
9	Anëtar	Erald Dalipi	